



Pranuar / Dorezuar Primljeni/Prodato Received/Delivery	26.01.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHINA	980/2023		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 1152/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari - kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi - anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.Nr.1152/2022, të datës 12.12.2022, së ankuesit [redacted], përmes përfaqësuesit të autorizuar avokat [redacted] me adresë banimi rruga „ Fehmi Agani”, hyrja 154, kati i I, NR.8, nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Administratës të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 1152/2022, e datës 12.12.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. MBETET në fuqi Vendimi i datës 29.11.2022, me numër protokollit 111-1065, si dhe Vendimi i datës 07.12.2022, me numër protokollit 111-1065/2, i Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administratës së Pushtetit Lokal.

Arsyetim

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 38 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datën 01.11.2022 ka shpallur njoftimin për Konkursin me

numër Reference RN000010286 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar për Integritet Evropian 1", në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi.

Konkursi në fjalë ka qenë i hapur nga data 16.11.2022 deri me datën 23.11.2022, dhe interesim konkurrimi kanë shprehur 2 kandidatë. Sipas vendimit me numër 111-1065 të datës 29.11.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore pranë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ankuesit i është refuzuar aplikacioni për arsye se i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e parapara për pozitën "Zyrtar për Integritet Evropian".

Ankuesi [redacted] i pa kënaqur me vendimin me numër 111-1065 të datës 29.11.2022, me datën 01.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër 111-1065/1 pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Ndërsa kjo e fundit me datën 06.12.2022 përmes vendimit me numër të protokollit 111-1065/2 e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar si dhe duke lënë në fuqi vendimin 111-1065 i datës 29.11.2022.

Ankuesi [redacted] i pa kënaqur me vendimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokat [redacted] me datë 12.12.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vendimit Nr.111/1056/2 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me datë 13.12.2022, ka dërguar përgjigje në ankese me numër protokollit 8012/2022 tek Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, ndërsa kjo e fundit me datë 21.12.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me të protokolluar me numër 8256/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr.1152/2022 e datës 12.12.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokollit 7884/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 07.12.2022, me numër protokollit 111-1065/2 i Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administratës së Pushtetit Lokal; Konkursi i datës 01.11.2022; Raporti i Monitorimit për Ministrinë e Administratës së Pushtetit Lokal; Ankesë e datës 01.12.2022, me numër protokollit 111-1065/2; Vërtetim i datës 07.07.2022; Vendimi i datës 29.11.2022, me numër protokollit 111-1065 i Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administratës së Pushtetit Lokal; Vendimi i datës 10.02.2022, i Komisionit Disiplinor; Vendimi i datës 02.08.2022, i zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm; Njoftimi i datës 07.12.2022; ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i datës 20.01.2014; Kërkesa për fillimin e rekrutimit e datës 10.10.2022; Njoftimi i datës 29.11.2022; Përshkrimi i detyrave të Punës; Vendimi i datës 30.11.2022, për Themelimin e Komisionit për Lëvizje brenda kategorisë; Vendimi i datës 23.09.2022, me numër protokollit 5642/2022, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aplikacioni i [redacted] me shkresat e bashkangjitura; diploma e datës 30.04.2020; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 01.07.2008; Ndryshimi dhe Plotësimi i akt emërimit i datës 21.01.2014; Vërtetim i datës 07.07.2022; Vendimi i datës 02.08.2022; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në Punë; Aplikacioni i Erolida Januzaj, me shkresat e bashkangjitura; Akt emërimi i datës

07.09.2017; Diploma e datës 24.11.2020; Kontrata për shërbimet të veçanta e datës 08.09.2016; Kontrata për shërbimet të veçanta e datës 17.05.2017; Kontrata për shërbimet të veçanta e datës 04.03.2016; Kontrata për shërbimet të veçanta e datës 12.10.2022; Vërtetim i datës 21.06.2022 Vërtetim i datës 26.09.2022; Përgjigje në ankesës e datës 21.12.2022, me numër protokolli 8256/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [REDAKTUAR] është e pa bazuar sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se si kushte të veçanta për lëvizje brenda kategorisë janë përcaktuar: *të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon: të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit, ndërsa si kritere të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a Universitare në drejtimin Ekonomi, Drejtësi, Administratë Publike si dhe Integritet Evropian me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to . **Përvoja e punës:** se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Lidhur me shqyrtimin e pretendimit ankimor të ankuesit se Njësia e Burimeve Njerëzore pranë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka bërë shkelje lidhur me marrjen e Vendimit Nr.111/1065 të datës 29.11.2022 me të cilin ankuesit i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk i plotëson kriteret për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit si dhe vendimit me Nr.111-1065/2 të datës 06.12.2022 me të cilin ankuesit i është refuzuar ankesa, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se edhe pse ankuesi ka dorëzuar dokumentacionin me rastin e aplikimit duke e dorëzuar dhe vërtetimin e datës 07.07.2022 me të cilin thuhet që nuk ka masë disiplinore që nuk është shuar, mirëpo në bazë të provave të lëndës, sipas Vendimit me Nr. Port:116-161 të datës 10.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në pikën dy të dispozitivit të tij është vendosur që të mbetet në fuqi vërejtja e shqiptuar nga Udhëheqësi i DFSHP-së, ndërsa si rezultat i kësaj Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka realizuar vizitë të jashtëzakonshme monitoruese në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe ndër të tjera sipas Vendimit Nr.4137/2022 të datës 07.09.2022, ka konstatuar që masa e lënë në fuqi sipas Vendimit Nr.116-116 të datës 15.02.2022 të Komisionit Disiplinor të MAPL-së të jetë në dosjen personale të zyrtarit, ndërsa sipas emailit të datës 09.09.2022 Sekretarja e Përgjithshme e MAPL-së ka njoftuar që masa disiplinore sipas Vendimit Nr.116-116 të datës 15.02.2022 të Komisionit Disiplinor të vendoset në dosjet personale të zyrtarëve, kurse më datë 21.09.2021 e njëjta ka kërkuar që a janë vendosur në dosje personale masa disiplinore ndërsa Sekretarja e Përgjithshme e MAPL-së më datë 21.09.2022 është njoftuar që masa disiplinore është vendosur në dosje personale të zyrtarëve në mesin e tyre edhe ankuesit.

Bazuar në këto, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi ka masë disiplinore në dosje personale dhe e cila nuk është shuar ende, rrjedhimisht Vendimi i datës 29.11.2022, me numër protokolli 111-1065 i Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administratës së Pushtetit Lokal, për mos përfshirje në listën e verifikimit paraprak për këtë arsye është në pajtim



Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6, nenin 41 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) NR. 16/2020 Për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili përcakton se: "2.Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon: 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit", ndërlidhur me nenin 45 paragrafin 3 të Rregullores (QRK) NR. 16/2020 Për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se; 3.Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin".


Lidhur me ligjshmërinë e Vendimit të datës 07.12.2022 me numër protokoll 111-1065/2 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administratës së Pushtetit Lokal, përmes të cilit ankuesit i është refuzuar ankesa është në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) NR. 16/2020 Për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës dhe i njëjti është i arsyetuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr. 1152/2022

Rushit KAJTAZI


Procesmbajtës

Malsore GASHI - BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit .
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Arkivit të KPMSHCK-së;

